



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 2499/6 prot.

Tiranë, më 22.12.2025

VENDIM

Nr. 45, datë 22.12.2025

PËR

ZBATIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 4, 5, 6, 7, pikës 1 dhe gërmës c), dh), e) dhe f) të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) në zbatim të detyrave të lëna nga rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2024”, si dhe bazuar në Planin e Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive 2025, ka kryer verifikimin e përmbushjes së detyrimeve të lëna, ndaj autoritetit publik “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a” (në vijim “autoriteti publik”) nëpërmjet Rekomandimit nr. 14, datë 29.10.2024.

Në pikën 1, të nenit 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”) parashikohet se: “*Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni*”. Në pikën 3, të nenit 4 të LDI përcaktohet se: “*Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik*.”.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “*Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike ...*”.

Bazuar në nenin 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “*Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar*”, i ndryshuar (në vijim “Urdhri nr. 187/2020”). Urdhri nr. 187/2020 është një akt nënligjor, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 224, datë 22.12.2020.

Gjithashtu, referuar shkronjës f) të nenit 9/1 të LDI Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale: “*bën rekomandime për autoritetet publike lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës*”.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura*”, rezulton se më datë 03.10.2022 është themeluar Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a. Në pikën 1 të nenit 2 të LDI përcaktohet se: “*Autoritet publik*” a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike*”. Për rrjedhojë, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a. konsiderohet autoritet publik, në kuptim të LDI.

Bazuar në sa më sipër, Zyra e Komisionerit ka dalë me Rekomandimin nr. 14, datë 29.10.2024 drejtuar autoritetit publik Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a. Nëpërmjet këtij rekomandimi i'u la detyrë të përmbushnin disa detyrime ligjore, ndër të cilat, të vinte në zbatim, publikonte, pasqyronte, përditësonte dhe ndërlidhte në Programin e Transparencës të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike, në përputhje me nenin 7 të LDI dhe Urdhrit nr. 187/2020, brenda një afati 90 ditor.

Në përfundim të afatit të lënë, nga monitorimi i kryer nga Zyra e Komisionerit rezultoi se autoriteti publik nuk ka faqe zyrtare në internet dhe nuk ka publikuar Programin institucional të Transparencës sipas modelit, duke mospërmbushur detyrimin ligjor bazuar në nenin 7 të LDI dhe Urdhrit nr. 187/2020.

Referuar konstatimeve të mësipërme, bazuar edhe në “*Planin e Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive të Autoriteteve Publike për vitin 2025*” miratuar nëpërmjet shkresës nr. 974 prot., Zyra e Komisionerit dërgoi Urdhrin nr. 193, datë 30.09.2025 “*Për kryerjen e hetimit administrativ*”, me objekt verifikimin e përmbushjes së detyrimeve të lëna në Rekomandimin nr. 14 datë 29.10.2024.

Më datë 23.10.2025, grupi i punës i Zyrës së Komisionerit u paraqit pranë autoritetit publik, ku pas verifikimit të fakteve dhe dokumentacionit, u mbajt procesverbali i hetimit administrativ me nr. 2499/2 prot., datë 23.10.2025 (administruar me nr. 1342 prot., datë 23.10.2025 nga autoriteti publik). Nga hetimi administrativ rezultoi se autoriteti publik

nuk ka përmbushur detyrimin për vënien në dispozicion dhe përditësimin e të gjitha kategorive të informacionit, që bëhen publike pa kërkesë, në Programin institucional të Transparencës. Autoritetit publik iu la afat deri më datë 31.10.2025 për të përmbushur detyrimet ligjore. Pas përfundimit të këtij afati, grupi punës i Zyrës së Komisioneri konstatoi se nuk është përmbushur detyrimi ligjor lidhur me publikimin/përditësimin e informacionit në Programin e Transparencës në faqen zyrtare.

Autoriteti publik ka njoftuar me shkresën nr. 1373 prot., datë 29.10.2025 (administruar me tonën me nr. 2499/3 prot., datë 31.10.2025), se ka afishuar në mjediset e institucionit Programin e Transparencës, me argumentin se faqja e vetme zyrtare e shoqërisë www.shuk.al/berat është në proces administrimi dhe mirëmbajtje nga Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizime (AKUK).

Referuar argumentimit të autoritetit publik sa më sipër, sqarojmë se afishimi i dokumenteve në mjediset e pritjes së autoritetit publik i shërben rritjes së transparencës së veprimtarisë së tij, por referuar pikës 3 të nenit 4 të LDI Programi i Transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik. Parashikimi ligjor përcakton qartë detyrimin për publikimin e informacionit në Programin e Transparencës në faqen zyrtare të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a. Për sa i përket argumentit se faqja e vetme zyrtare është në proces administrimi nga AKUK, sqarojmë se autoriteti publik nuk ka paraqitur asnjë argumentim ligjor që referon përcaktimin e AKUK si autoritet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me publikimin dhe përditësimin e informacionit në Programin e Transparencës. Referuar përcaktimit të shkronjës b) (i) të pikës 1 të nenit 2 të LDI, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a është autoritet publik, subjekti i këtij ligji dhe për rrjedhojë, është përgjegjëse për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga LDI.

Në këto kushte, me qëllim ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar të personit përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me publikimin dhe përditësimin e informacionit në Programin e Transparencës, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, me shkresën nr. 2499/4 prot., datë 07.11.2025, Komisioneri njoftoi zhvillimin e një seancë dëgjimore.

Me anë të shkresës së sipërcituar, seanca dëgjimore u njoftua të zhvillohet më datë 14.11.2025. Autoriteti publik, nëpërmjet postës elektronike më datë 11.11.2025, konfirmoi pjesëmarrjen e njërit prej koordinatorëve në këtë seancë, i pajisur me akt përfaqësimi. Zyra e Komisionerit zhvilloi në datën dhe orën e caktuar seancën dëgjimore me praninë e koordinatorit, por nuk u paraqitur titullari i autoritetit publik si personi përgjegjës për miratimin/përditësimin e Programit të Transparencës.

Referuar pikës 1 të nenit 19 të LDI përgjegjësia për vënien në zbatim dhe përditësimin e Programit institucional të Transparencës rezulton e titullarit të autoritetit publik, z. Pelivan Sinaj.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të pasur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë.

Nga ana tjetër, Programi i Transparencës përfaqëson një nga instrumentet kryesore të promovimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike dhe garantimit të së drejtës për informim të publikut, për rrjedhojë çdo autoritet publik është i detyruar ligjërisht për vënien në zbatim dhe përditësimin me informacion të tij.

Në përputhje me Programin e Transparencës të miratuar për çdo autoritet publik, këta të fundit përgatisin në formate lehtësisht të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet, kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të LDI.

Pika 1 e nenit 18 të LDI parashikon, se: *“Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”*. Shkronja b) e pikës 2 të nenit 18 të LDI parashikon, se: *“mosvënia në zbatim e programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë”*.

Pika 1 e nenit 19 të LDI parashikon, se: *“Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore-administrative për shkelje administrative të parashikuara në shkronjën b) të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji”*.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi dhe hetimi administrativ i zhvilluar, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për vënien në zbatim të Programit të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 187/2020 *“Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”*, i ndryshuar, mosveprim që konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me gërmën b), të pikës 2 të nenit 18 të LDI.

Duke marrë parasysh rrethanat e rastit, faktin që personi përgjegjës nuk është përsëritës në shkeljen e detyrimeve ligjore të sipërpërmendura dhe gjithashtu, bazuar në parimin e proporcionalitetit, dënimi me masë administrative (gjobë) vlerësohet të jetë në kufirin minimal.

PËR KËTO ARSYE:

bazuar në shkronjën “dh” të pikës 2 të nenit 9/1, të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 18, pikën 1 të nenit 19, pikës 1 dhe 2 të nenit 21 dhe nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”* dhe shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. autoriteti publik “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sh.a.”, në zbatim të shkronjave a), b) dhe c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të*

drejtën e informimit”, i ndryshuar, të vërë në zbatim, publikojë, pasqyrojë, përditësojë dhe ndërlidhë në Programin e Transparencës, në përputhje me nenin 7 të LDI dhe duke pasur në konsideratë kufizimet e nenit 17 të tij, si dhe sipas formatit të miratuar me Urdhrin nr. 187/2020 *“Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar”*, i ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 31.12.2025.

2. Dënimin e titullarit të autoritetit publik, z. Pelivan Sinaj, Administrator i Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a., në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
3. Masa e dënimit me gjobë shlyhet me këste mujore. Gjoka ekzekutohet nga zyra e financës së autoritetit publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikën 1 të këtij vendimi, autoriteti publik ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 18 të ligjit *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 2, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me ligjin nr. 10279/2010 *“Për kundërvajtjet administrative”*.

Ky vendim u shpall sot në datë 22.12.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi